



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër:463-01/36018, 28 Maj 2024

Në bazë të nenit 12 par.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënjen në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenit 18 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28 Maj 2024, merr këtë:

VENDIM

Nr.18/2024

Mbi formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale

- MIRATOHET**- Vendimi për formimin e komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës .
- Komisioni ankesave sipas këtij vendimi përbehet prej 5(pesë) anëtarëve si me poshtë:
 - Shqiprim Muriqi anëtarë i kuvendit nga subjekti i LDK-së,
 - Bujar Agusholli anëtarë i kuvendit nga subjekti LVV-së,
 - Albulena Mujaj Bajraktaraj - anëtarë nga ekzekutivi i komunës - drejtoreshë në DMS.
 - Nita Panduri Mullarama - anëtarë nga ekzekutivi i komunës – drejtoresh në DA ,
 - Gent Agolli anëtarë nga sektori joqeveritar anëtarë.
- Kryesuesi i Komisionit të ankesave zgjidhet me shumicë votash nga radhët e anëtarëve të Komisionit .
- Mandati i komisionit të ankesave është është dy (2) vite brenda mandati të Kuvendit të Komunës.
- Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit ankesave është:
 - Pranimini i ankesave të paraqitura në vlerësimin e ofertave,
 - Shqyrtimi i ankesave,
 - njoftimi mbi vendimin e marrë të kryesuesit dhe kryetarit të komunës.
- Administrata e Komunës i ofronë përkrahje komisionit të ankesave sipas kërkesës se tyre.
- Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
- Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në ëeb faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

